

SALI KADRIA

**ASPEKTE TË GJENDJES SË NACIONALIZMIT SHQIPTAR
GJATË VITEVE 1916-1918 NË ZONËN E PUSHTIMIT
AUSTRO-HUNGAREZ**

Lufta e Parë Botërore “e preku në zemër zhvillimin” e shtetit dhe të nacionalizmit shqiptar, sepse Shqipëria u kthye në shesh lufte e ushtrive të ndryshme. Shteti kombëtar shqiptar, i cili filloi të ngrihej me shumë mundime u shpërbë aq shpejt sikur të mos kishte ekzistuar më parë. Kjo i dha një goditje të rëndë aspiratave të nacionalizmit shqiptar, pasi shqiptarët mbetën në mëshirën e fatit. Qysh në fillim të luftës, qeveritë e të dy koalicioneve ndërluftuese u përpoqën të preknin ndjenjat kombëtare të shqiptarëve, me qëllim që të gjenin mbështetje për ushtritë e tyre në pjesën perëndimore të Ballkanit¹.

Për shkak të përndjekjes nga ana e kryengritësve, nacionalistët shqiptarë u larguan në drejtime të ndryshme. Një pjesë e tyre, si Aqif Pashë Elbasani, Refik Bej Toptani, Fuad Bej Toptani, Kara Seit Pasha, Bajram Curri, Isa Boletini, Bajram Daklani si dhe shumë shqiptarë nga Kosova u vendosën në qytetin e Shkodrës. Këta të fundit mendonin se prej aty mund të hynin në territoret shqiptare të aneksuara nga Serbia². Me nxitjen e konsullit austro-hungarez Halla, grupi nacionalist i Kosovës mori përsipër të organizonte çeta për të luftuar me forcat serbe në territorin e Kosovës³. Në shkurt të vitit 1915, një grup kryengritësish shqiptarë me në krye Hasan Bej Prishtinën dhe Bajram Bej Currin kaloi kufirin dhe zhvilloi luftime kundër forcave serbe duke i dëbuar ato deri në Carralevë të Prizrenit. Për shkak të qëndrimit të lëkundur të disa

¹ Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, përkthyer nga Korab Hoxha dhe Fatmir Mborja, Tiranë: “Ideart”, 2004, f. 85.

² *Haus - Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien*, (më tej: *HHStA, PA, A*), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 25-4-485, Telegram i ambasadorit austro-hungarez (më tej: a-h) Pallaviçini, drejtuar ministrit të Jashtëm në Vjenë, Stamboll, 26 janar 1915.

³ *Po aty*, Vj. 25-4-483, Telegram i konsullit a-h Halla drejtuar MPJ në Vjenë, Shkodër, 29 janar 1915.

bajraktarëve, kjo ekspeditë nuk arriti objektivat që nacionalistët i kishin vënë vetes⁴.

Në pranverë të vitit 1915, në Shkodër u formua organizata “Komiteti i Fshehtë” (pjesë e ish Krahut Kombëtar) me kryetar Hoxhë Kadriun. Kjo organizatë nacionaliste kishte synim mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare, çlirimin e Kosovës nga forcat serbe dhe bashkimin e saj me shtetin shqiptar⁵, pasi shqiptarët ishin sërish një nga kombet më të rrezikuar për t’u zhdukur.

Pas muajit shtator 1915, një pjesë e grupit nationalist shqiptar shkoi për të gjetur mbrojtje në krahinën e Matit, ku vepronte Ahmet Zogu⁶. Një pjesë tjetër e nacionalistëve shqiptarë shkuan në Amerikë. Ardhja e tyre e forcoi më shumë Federatën Panshqiptare “Vatra”, e cila u bë organizata më e fuqishme kombëtare shqiptare. Gjatë viteve të luftës, kjo organizatë kombëtare veproi “si guvernë shqipëtare”⁷. Drejtuesit e kësaj organizate shpallën fushatën për dërgimin në atdhe të trupave vullnetare kombëtare për mbrojtjen e territorit të Shqipërisë nga rreziku i pushtimit grek.

Drejtuesit e Federatës Panshqiptare “Vatra” në SHBA hartuan një program kombëtar “për të shpëtuar Shqipërinë nga copëtimi dhe humbja”. Programi parashikonte ruajtjen e asnjësisë së shqiptarëve në luftën e madhe, pasi vetëm ky qëndrim mbronte më mirë çështjen kombëtare. Ai synonte gjithashtu bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një qendër të përgjithshme⁸. Ky program u hartua në kushtet kur vendi ishte i pushtuar dhe nacionalizmi shqiptar nuk kishte ende një qendër të vetme drejtuese dhe as një platformë unike kombëtare. Megjithatë, përpjekjet

⁴ Fejzi Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike (1891-1921)*, Tiranë: “Albas”, 2012, f. 95.

⁵ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*, (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 882, Dosja (më tej: D.) 9, fl. 707-708, “Komiteti i Fshehtë”; Eqber Skëndi, *Hoxhë Kadriu*, Prishtinë: 1992, f. 36; Kristo Floqi “Kosova. Serbi e Vjetër!” (Studim etnografik e statistik, përgjegje z. Prof. Zvijich-it), *Agimi*, Shkodër, nr. 2, qershor 1920, f. 33-36; “Nji vështrim mi gjendjen t’onë”, *Populli*, Shkodër, nr. 50, 13 maj 1915, f. 1.

⁶ Nikollë Ivanaj, *Historija e Shqipëniës – Vujejtjet e veprimet e mija*, Pjesa e Parë, Tiranë: Shtypshkronja e Shtetit “Atdheu”, 1943, f. 63.

⁷ *Dielli*, Boston Mass., nr. 485, 6 shtator 1915, f. 2, artikull i shkruar me pseudonimin “Atdhetari”; Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra” (1912-1920)*, Tiranë: Globus R, 2001, f. 143.

⁸ *AQSH*, F. 100, D. 11, fl. 1-2, Raport i një personi [firma e palexueshme-S.K.] dërguar Federatës “Vatra” ku paraqitet një program për bashkimin e shoqërive të ndryshme jashtë vendit në një të vetme, Natick Mass., 1 Vjeshtë e parë 1915.

për formimin e një komiteti të përbashkët kombëtar të kolonive shqiptare nuk patën sukses për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet mbështetësve të Fan Nolit dhe Kristo Dakos.

Shumica e nacionalistëve shqiptarë dëshironin shpirtërisht fitoren e Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë, pasi shteti austro-hungarez ishte kundër serbëve. Gjithashtu, Austro-Hungaria kishte mbrojtur çështjen kombëtare shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër⁹. Më 23 janar të vitit 1916, forcat e ushtrisë austro-hungareze hynë në rrethinat e Shkodrës. Më 28 janar 1916, një grup shqiptarësh i përbërë nga personalitete me ndikim në jetën politike dhe kombëtare të vendit si, Preng Bibë Doda, Seit Pasha, Fejzi Alizoti, Luigj Gurakuqi dhe Aqif Pashë Elbasani, përmes një shpallje u kërkuan shqiptarëve që t'i prisnin forcat austro-hungareze si “çlirimtarë”, sepse ato po dëbonin pushtuesit serbo-malazezë duke shmangur aneksimin e Shkodrës nga Mali i Zi¹⁰.

Më 1 prill 1916, komandanti i trupave austro-hungareze në Shqipëri, gjenerali I. Trollman, shpalli vendosjen e administratës ushtarake austro-hungareze. Në deklaratën e tij, ai theksoi se kjo gjendje do të vazhdonte deri sa të krijoheshin kushtet e përshtatshme në Shqipëri. Me këtë akt, Austro-Hungaria shkeli zyrtarisht vendimet e Konferencës së Londrës që e njihnin Shqipërinë, shtet të pavarur dhe neutral. Nga një fakt i pranuar ndërkombëtarisht, pavarësia e Shqipërisë u kthye në një premtim¹¹.

Pavarësisht kushteve të krijuara, nacionalistët shqiptarë synonin ruajtjen e Shqipërisë së pavarur dhe përfshirjen brenda saj edhe të trojeve të tjera etnike të shkëputura prej saj padrejtësisht. Në funksion të këtij qëllimi, nacionalistët shqiptarë shtruan dy objektiva kryesore politike: ngritjen e një qeverie shqiptare dhe thirrjen e një kongresi kombëtar shqiptar për të përcaktuar objektivat kombëtare për të ardhmen¹². Në

⁹ Mehdi Frashëri, *Kujtime - vitet 1913-1933*, Tiranë: Omsca-1, 2005, f. 28-31.

¹⁰ Lef Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare*, Botim i dytë, përgatitja për botim dhe redaktimi shkencor nga prof. dr. Marenglen Verli dhe prof. dr. Ferit Duka, Tiranë: “Nënë Tereza”, 2007, f. 244-246; *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 84; Xhevat Repishti, “Kryengritja kundër sundimit austro-hungarez, tetor 1918”, në: *Kumtari*, Shkodër, nr. 6, 1993, f. 23.

¹¹ Syrja Vlora, *Kujtime – Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përgatitur për botim dhe redaktuar nga akad. assoc. Marenglen Verli dhe dr. Ledia Dushku, Tiranë: Iceberg, 2013, f. 164.

¹² Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*, Tiranë: 1987, f. 256.

fillim të vitit 1916, Ahmet Zogu u rishfaq si një figurë kombëtare mjaft aktive në skenën politike të vendit. Duke shfrytëzuar zbrazëtinë e krijuar në viset e Shqipërisë së Mesme, A. Zogu në krye të një force të përbërë nga mbështetës të tij, hyri në qytetin e Elbasanit. Në këtë qytet u arrit të vendosej administrata me prefekt Irfan Ohri (i nipi i Aqif Pashë Elbasanit), përdorimi i gjuhës shqipe dhe flamujve shqiptarë dhe bullgarë¹³. Forcat mbështetëse të Ahmet Zogu arritën të merrnin nën kontroll, territorin Elbasan-Peqin-Lushnje-Mallakastër-Berat dhe Skrapar¹⁴.

Ahmet Zogu u takua në Elbasan me patriotë të shquar si Aqif Pashë Elbasani, Mid'hat Frashërin dhe Lef Nosin. Ai shtroi idenë e thirrjes së një kongresi me synim që të formohej “një Pleqësi e popullit” dhe të deklarohet zyrtarisht nga kuvendi kombëtar neutraliteti i Shqipërisë deri në mbarim të luftës¹⁵. Qëllimi i tyre ishte ringritja e administratës shqiptare që të ruhej vijimësia e shtetit kombëtar shqiptar qoftë edhe nën kontrollin austro-hungarez. Gjatë muajve shkurt-mars 1916, nën drejtimin e Ahmet Zogut u formua “Komisioni i Veprimit” në Elbasan, i përbërë nga figura të spikatura të nacionalizmit shqiptar si, Aqif Pashë Elbasani, Lef Nosi, Ahmet Haxhisinani, Sava Papajani, Shefqet Daiu, Simon Shuteriqi, Ymer Stringa e të tjerë¹⁶. Ky komision i kërkoi Aqif Pashës që në kushtet “e mungesës së çdo lloj administrate në Shqipëri” dhe meqenëse ai kishte mbajtur detyrën e “ministrit të Punëve të Brendshme dhe atë të ministrit të Drejtësisë”, gjatë periudhës së Princ Vidit, të ftonte të gjithë ish kolegët e tij ministra në Elbasan, për të formuar një qeveri të re pasi zyrtarisht qeveria e Turhan Pashës nuk kishte dhënë dorëheqje. Aqif Pashë Elbasani emëroi disa prefektë, nënprefektë, kryetarë komunash, kryesisht në Elbasan, Durrës dhe Berat. Emërimi i drejtuesve vendorë mendohej si hapi i parë në drejtim të

¹³ L. Nosi, *Dokumenta historike...*, Të hymit e Ushtëriës Bulgare n'Elbasan, Proces - Verbal, 29 Kallinduer 1916, f. 246; *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-18-1850, Aneks për raportin nga Shkodra nr. 16/pol. i Stacion komandës Perandorake dhe Mbretërore në Elbasan, Shkodër, 23 mars 1916.

¹⁴ *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-10-1022, Letër e komandantit të trupave kombëtare në Shqipëri Ahmet Muftar Zogolli, drejtuar komandantit të forcave a-h në Shkodër, Elbasan, 5 mars 1916.

¹⁵ *Po aty*, Vj. 26-18-1850, Aneks për raportin nga Shkodra nr. 16/pol i Stacion komandës Perandorake dhe Mbretërore në Elbasan, Shkodër, 23 mars 1916.

¹⁶ L. Nosi, *Dokumente historike...*, Botimi dytë, f. 183; M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet...*, f. 256.

ringritjes së një qeverie shqiptare, e cila do të kishte në përbërje ministrat e qeverisë së Princ Vidit¹⁷.

Më 18 shkurt 1916, Ahmet Zogu, në cilësinë e kryetarit të komisionit nismëtar njoftoi telegrafisht drejtuesit e prefekturave, nënprefekturave, krahinave kryesore si dhe kolonitë shqiptare në Bukuresht, Sofje, Lozanë se me datën 2 prill [1916], në qytetin e Elbasanit do të “mbahej një kongres Kombëtar Shqiptar i organizuem prej Ahmet beut...”¹⁸. Ai u kërkoi që të dërgonin përfaqësuesit “për të biseduar mbi punët e Shqipërisë dhe për të vendosur mbi fatin e saj”¹⁹. Nacionalistët shqiptarë mendonin se me rikthimin e Princ Vidit në Shqipëri, qeveria shqiptare do të merrte formën e një qeverie të ligjshme. Gjithashtu, përpjekjet e tyre synonin t’u dëshmonin autoriteteve austro-hungareze se shqiptarët kishin aftësi shtetformuese dhe qeveria do të shërbente si argument kryesor për ruajtjen e shtetit kombëtar shqiptar pas luftës²⁰.

Nënkonsulli austro-hungarez njëkohësisht shef i Zyrës së Zbulimit në Elbasan, von Zitkovski mbështeti idenë e nacionalistëve shqiptarë për thirrjen e kongresit²¹. Përmes Aqif Pashës, ushtarakët austro-hungarezë synonin të neutralizonin pa fërkime propagandën bullgare. Për arsyet e mësipërme, feldmareshalli austro-hungarez Sorçiç i dha leje Ahmet Zogut dhe Irfan Beut për mbajtjen e këtij kongresi²². Por, nisma e ndërmarrë nga nacionalistët shqiptarë u kundërshtua nga konsulli i Përgjithshëm Kral. Ai dyshonte se organizimi i kongresit kombëtar nga nacionalistët shqiptarë, synonte “ngritjen e administratës dhe të çështjeve të ndryshme nacionale...[si dhe] do të shtronte nevojën e çlirimit dhe të

¹⁷ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-6-620, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h në Shkodër Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 22 mars 1916; M. Çami, Shqipëria në marrëdhëniet..., f. 257.*

¹⁸ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-6-634, Telegram i togerit von Zistovski-t në Elbasan drejtuar Kryekomandës së ushtrisë a-h në Shkodër, Elbasan, 12 mars 1916.*

¹⁹ L. Nosi, *Dokumenta historike...*, Programma e Kongresit, f. 251; Teki Selenica, *Shqipëria më 1937 – Veprimi Shtetnor gjat njëzet e pesë vjeteve të parë të vetqeverimit*, Vëllimi 1, Tiranë: Shtypshkronja Kristo Luarasi, 1937, f. 12.

²⁰ M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet..., f. 258.*

²¹ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-6-634, Telegram i togerit von Zistovski-t në Elbasan, drejtuar Kryekomandës së ushtrisë a-h në Shkodër, Elbasan, 12 mars 1916; Po aty, Vj. 26-18-1850, Aneks për raportin nga Shkodra nr. 16/pol i Stasion komandës Perandorake dhe Mbretërore në Elbasan, Shkodër, 23 mars 1916.*

²² *Po aty, Vj. 26-6-626, Kopje të telegrameve të togerit von Zistovski-t në Elbasan, drejtuar Kryekomandës së ushtrisë a-h në Shkodër, Elbasan, 14 dhe 15 mars 1916.*

bashkimit të gjithë krahinave shqiptare”²³. Konsulli Kral dyshonte se oficeri austro-hungarez i zbulimit po përpiquej të bënte për vete figurat nacionaliste shqiptare, në mënyrë që të eklipsohej prania dhe detyra për të cilën ai ishte ngarkuar. Vjena zyrtare doli në mbështetje të Kralit, duke kërkuar ndalimin e mbajtjes së këtij kongresi. Komanda ushtarake austro-hungareze urdhëroi komandat vartëse “që të mos lejonin në këtë kohë mbledhje politike në krahinat e okupueme prej nesh”²⁴.

Ndalimi i mbledhjes kombëtare me ndihmën e forcave bullgare, shpërndarja e “qeverisë” së formuar nga Aqif Pashë Elbasani dhe proklamata e komandës austriake në Shqipëri e datës 23 janar 1917, në të cilën deklarohet se Austro-Hungaria do t’u jepte vetëqeverisjen shqiptarëve, sapo të krijoheshin kushtet e duhura²⁵, i zhgënjeu nacionalistët shqiptarë. Shpallja e 23 janarit 1917, në përmbajtjen e saj ishte një shkrirje e dy pikëpamjeve të ndryshme që ishin të pranishme në rrethet diplomatike dhe ushtarake të Vjenës.

Nacionalistët shqiptarë e kuptuan qartë se Shqipëria u trajtua prej qeverisë austro-hungareze si një vend i pushtuar. Me këtë akt iu dha një goditje e rëndë të gjitha arritjeve kombëtare të shqiptarëve në planin e brendshëm dhe të jashtëm²⁶. Nacionalistët shqiptarë i zhgënjeu veçanërisht koncepti austriak mbi “papjekurinë” politike të shqiptarëve dhe mohimi i ndjenjave të tyre kombëtare²⁷. Megjithatë, një pjesë e patriotëve shqiptarë vazhdonin të kishin shpresë se vetëm në sajë të mbrojtjes së Austro-Hungarisë, shqiptarët do të arrinin të çlironin të gjitha territoret shqiptare dhe të punonin për forcimin e kombit shqiptar²⁸. Pavarësisht rrezikut që ishte i pranishëm, nacionalistët shqiptarë u përpoqën t’i përshtateshin kushteve të reja që u krijuan në vend. Grupimi kombëtar ishte i mendimit se në përfundim të luftës, Shqipëria duhej të ruhej me çdo mënyrë si shtet i pavarur. Për këtë arsye, nacionalistët u

²³ *Po aty*, Vj. 26-6-635, Telegram shifër i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 16 mars 1916.

²⁴ *Po aty*, Vj. 26-6-631, Telegram shifër i kontit Turn, drejtuar MPJ, datë 17 mars 1916.

²⁵ *Po aty*, Vj. 26-6-618, Telegram shifër e MPJ drejtuar Kral, konsullit të Përgjithshëm a-h në Shkodër, Vjenë, 23 mars 1916; *Po aty*, Vj. 27-8-819, Telegram shifër i Konsullit të përgjithshëm a-h Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 23 janar 1917; *Posta e Shqypënis*, Shkodër, 24 janar 1917, f. 1; Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005, f. 218.

²⁶ M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet...*, f. 276.

²⁷ *Posta e Shqypënis*, Shkodër, 6 janar 1917, f. 1.

²⁸ “Bashkimi”, *Posta e Shqypënis*, Shkodër, nr. 15, 27 janar 1917, f. 1.

përpoqën të shfrytëzonin të gjitha mjetet që patën në dispozicion në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare.

Organizimi i administratës civile të vendit iu besua konsullit të Përgjithshëm August Ritter von Kral, i cili ishte një nga njohësit më të mirë të çështjes shqiptare. Pas shtatorit 1916, ai e zgjeroi fushën e veprimit të tij në Shqipëri duke u bërë drejtuesi kryesor i veprimtarisë së administratës politike, financiare, drejtësisë dhe i arsimit²⁹. Në Shqipëri u krijua një administratë e përbërë nga shqiptarë nën kontrollin austro-hungarez, që shtrihej nga Malësia e Shkodrës deri në lumin Vjosa³⁰. Për të ruajtur unitetin kombëtar në mesin e shqiptarëve, drejtuesit e administratës austro-hungareze kërkuan që kufiri i territorit të okupuar prej tyre të zbriste të paktën deri në vijën e lumenjve Seman dhe Osum. Ata kishin mendimin se lumi Shkumbin përbënte “kufirin etnografik midis Shqipërisë së veriut e të jugut”. Caktimi i këtij lumi si kufi jugor i territoreve shqiptare të okupuara nga forcat austro-hungareze “do të ishte pothuajse një goditje fatale për gjendjen shpirtërore të shqiptarëve, sepse do të shtonte dyshimin tek shqiptarët për ndarjen e tyre”³¹.

Mendësia perandorake e drejtuesve të administratës civile austro-hungareze u reflektua edhe në mënyrën e organizimit dhe zbatimit të kësaj administrate në Shqipëri. Austriakët u njohën shqiptarëve të drejtat e tyre kulturore si dhe lejuan organizimin e një administrate autonome shqiptare. Figura të rëndësishme kombëtare shqiptare, të larguar nga vendi, u ftuan të vinin për të kontribuar në dobi të atdheut³². Mjaft prej tyre u mbështetën politikisht dhe u ngarkuan me detyra të rëndësishme në administratën shqiptare. Ky akt ndikoi në krijimin e rrjeteve sociale të bashkëpunimit kombëtar. Thelbi i këtij projekti synonte organizimin administrativ të vendit mbi baza moderne, me qëllim që të kishte një “drejtim unik”. Në Shkodër u krijua një administratë qendrore e drejtuar nga shqiptarë, e cila ishte nën kontrollin e Komandës së Lartë austro-hungareze në Shqipëri të drejtuar nga nënkolonel Juha dhe majori

²⁹ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-16-1637*, Raport i Konsullit të përgjithshëm a-h Kral drejtuar MPJ, Shkodër, 15 shtator 1916.

³⁰ F. Alizoti, *Kujtimet e jetës...*, f. 104.

³¹ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-6-647*, Deklaratë lidhur me çështjen e vendosjes së një qeverie të përgjithshme ushtarake të Shqipërisë, 12 janar 1918.

³² *AQSH, F. 17, D. 39, fl. 6-8*, Lutje një grupi shkodranësh për kthimin e Gjergj Fishtës në Shkodër, drejtuar Emzot Jakë Serreqit, Kryepeshkv Metropolit i Shkodrës, Shkodër, 26 shkurt 1915.

Popler³³. Administrata shqiptare u përqendrua në tri drejtori kryesore: Drejtoria e Përgjithshme e Financave me drejtues Fejzi Alizotin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit me drejtues Luigj Gurakuqin si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë, e cila në fillim kishte drejtor Masar Asllanin dhe më pas Avni Dabullën³⁴. Pak kohë më vonë, u bë organizimi administrativ i vendit në rrethe, qarqe dhe komuna³⁵.

Gjatë periudhës 1916-1918, autoritetet e larta të administratës ushtarake në Shqipëri dhe drejtuesit e nacionalizmit shqiptar u përpoqën të përfitonin sa më tepër nga njëri-tjetri. Nga njëra anë, Austro-Hungaria u bëri shqiptarëve lëshime kryesisht në fushën e të drejtave kulturore dhe forcimit të administratës publike. Me këto lëshime, ajo synonte t'i bënte për vete shqiptarët në luftën e saj kundër fuqive kundërshtare. Nga ana tjetër, edhe nacionalistët shqiptarë u përpoqën të përfitonin nga lëshimet për të punuar në dobi të çështjes kombëtare. Ata synuan jo vetëm t'u shkëpusnin autoriteteve austro-hungareze sa më tepër të drejta kulturore, por edhe të realizonin platformën kombëtare për bashkimin e tokave etnike në një shtet të vetëm shqiptar. Megjithatë, duhet theksuar se veprimtaria e nacionalistëve shqiptarë u zhvillua aq sa u lejonin rrethanat e luftës, sepse ushtria austro-hungareze zbatoi pa mëdyshje ligjin e luftës ndaj të gjithë atyre që merreshin me veprimtari politike.

Lufta e Parë Botërore pati rrjedhoja negative të rënda për shqiptarët. Megjithatë, ajo ndikoi në forcimin e nacionalizmit dhe të administratës shtetërore shqiptare. Shqiptarët nxorën mësim të vlefshme për rëndësinë që kishte shteti kombëtar si dhe nga reformat administrative të kryera nga autoritetet ushtarake austro-hungareze. Modeli i aplikuar nga austriakët në Shqipëri nxiti mobilizimin social dhe rrëzoi kufijtë kulturorë ndërmjet shqiptarëve. Ai u shfrytëzua nga drejtuesit politikë shqiptarë në periudhën pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

Nacionalistët shqiptarë, në bashkëpunim me autoritetet austro-hungareze, shtruan tri detyra kryesore për përhapjen e idesë kombëtare në mesin e shqiptarëve: së pari, përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe sipas një programi unik në të gjitha shkollat e Shqipërisë; së dyti, emërimin në

³³ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)* (Kujtime dhe vlerësime historike), Botim i dytë, përgatitur nga prof. dr. Marenglen Verli, Tiranë: Vllamasi, 2012, f. 131.

³⁴ F. Alizoti, *Kujtimet e jetës...*, f. 101-102.

³⁵ *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 28-6-659*, Raporti i konsullit të Përgjithshëm Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 24 maj 1918.

administratën shtetërore të shqiptarëve të ndershëm që njihnin mirë gjuhën shqipe në të folur dhe në të shkruar; së treti, përhapjen në mesin e të rinjve, në administratën shtetërore dhe në masën e gjerë të popullit, të librave dhe gazetave kombëtare në gjuhën shqipe, të cilat të ishin të kuptueshme për ta³⁶.

Gjatë viteve 1916-1918, autoritetet ushtarake-civile austro-hungareze synuan që në viset shqiptare të kontrolluara prej tyre, të ndërtonin një administratë të rregullt dhe efikase, mbështetur në modelin e Evropës Perëndimore³⁷. Qëllimi i tyre ishte që administrata vendore shqiptare të krijonte kushtet që të gjithë shqiptarët të gëzonin të drejtat e tyre. Ata mendonin se në këtë mënyrë, popullsia nuk do të kishte arsye për të paraqitur ankesa në drejtim të administratës³⁸. Sipas këndvështrimit të zyrtarëve austriakë, prishja e rendit dhe e qetësisë së vendit do të kishte rrjedhojë, humbjen e autoritetit, rëndësisë dhe të besueshmërisë së administratës kundrejt popullit. Drejtuesit e administratës ushtarake austro-hungareze, të njohur si “specialistë” të administrimit të kombeve të ndryshme brenda perandorisë së tyre, hodhën bazat e administratës moderne shqiptare. Me zbatimin e rreptë të ligjeve dhe urdhrave, u dëshmuar qartë shqiptarëve se mbi fuqinë individuale qëndron fuqia kolektive dhe autoriteti qeveritar, të cilit duhej t’i nënshtrohej detyrimisht çdo shqiptar³⁹.

Si rrjedhojë e vendosmërisë së nacionalistëve shqiptarë dhe politikës së ndjekur nga autoritetet austro-hungareze, administrata e krijuar prej tyre hodhi hapa të rëndësishëm për krijimin e elementëve të parë të kategorisë së nëpunësve shqiptarë sipas modelit perëndimor⁴⁰. Punonjësit e administratës filluan t’i nënshtroheshin përzgjedhjes duke u mbështetur në kriteret e aftësisë. Kriteri kryesor për t’u punësuar në administratën vendore ishte shkolla e kryer nga kandidatët, si dhe aftësia e nëpunësve të

³⁶ Gjergj Fishta, “Gjuha Shqype”, *Posta e Shqypënie*, Shkodër, nr. 23, 24 shkurt 1917, fq. 1.

³⁷ Franz Seiner, *Numrim i parë i popullsis në Shqypni*, nxjerrë prej *Hyllit të Dritës* të vjetës 1922-1923, Shkodër: Shtypshkroja Franciskane, 1922, f. 4.

³⁸ *AQSH*, F. 271, D. 3, fl. 23, Shkresë e nënprefektit të Elbasanit Dervish Hima, drejtuar Drejtorisë së Dumresë në Belsh, Elbasan, 2 shtator 1917.

³⁹ S. Vllamasi, *Ballafaqime politike...*, f. 133.

⁴⁰ *HHSStA, PA, A, në AIH*, Vj. 28-3-388, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 4 mars 1918.

administratës për të shkruar dhe lexuar mirë gjuhën shqipe”⁴¹. Nëpunësit e administratës në zonën e pushtimit austro-hungarez, përbëheshin nga zyrtarë shqiptarë që ishin pothuajse nga të gjitha krahinat e banuara nga shqiptarë.

Krahas ruajtjes së shqipes si gjuhë zyrtare në administratën vendase, autoritetet austro-hungareze i lejuan shqiptarët të përdornin edhe flamurin kombëtar shqiptar. Ato nxitën përhapjen e shtypit të shkruar në Shqipëri si mjet i përshtatshëm për nxitjen e idesë kombëtare ndër shqiptarë⁴². Drejtuesit e lartë të administratës civile shqiptare urdhëruan nëpunësit vendorë t’i hartonin raportet e tyre në gjuhën shqipe ose në atë gjermane⁴³. Administrata shqiptare në zonën e pushtuar nga forcat austro-hungareze krijoi një model të standardizuar dhe unik për mënyrën e formulimit dhe të shkrimit të shkresave zyrtare⁴⁴.

Drejtoria e Përgjithshme e Financave pati meritë të veçantë në drejtim të forcimit të administratës fiskale. Komunikimi zyrtar i administratës fiskale që ishte kryesisht në gjuhën turke u zëvendësua me gjuhën shqipe. Të gjithë librat, regjistrat, rregulloret, urdhëresat e administratës fiskale u përpunuan dhe u redaktuan në gjuhën shqipe. Kjo drejtori urdhëroi drejtuesit e pushtetit vendor që gjatë procesit të mbledhjes së taksave, të lehtësonin por njëkohësisht të mbikqyrnin veprimet e taksidarëve dhe të dhjetarëve. Arritjet e shënuara në këtë drejtim, nxitën Ministrinë e Punëve të Jashtme t’u kërkonte drejtuesve të administratës vendore në Shkodër, për hartimin e një buxheti të veçantë⁴⁵.

Arritja e këtyre ndryshimeve pozitive në vend, u realizua edhe falë punës së konsullit të Përgjithshëm Kral, i cili synoi “shqiptarizimin

⁴¹ *AQSH*, F. 271, D. 8, fl. 5, Përgjigje e drejtorit të Kadastrës Elbasan drejtuar Zyrës së Financave të Elbasanit, Elbasan, 22 nëntor 1917; *Po aty*, F. 271, D. 8, fl. 6, Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Financave drejtuar Zyrës së Financave në Elbasan, Shkodër, 2 nëntor 1917.

⁴² *HHSStA*, PA, A, në *AIH*, Vj. 26-20-2031, Shkresë e MPJ nr. I/A, nr. 249 drejtuar Rappaport, Vjenë, 19 janar 1916; *Po aty*, Vj. 26-20-2012, Shkresë e MPJ për konsullin a-h në Shkodër Kral, datë 8 prill 1916.

⁴³ *Po aty*, Vj. 26-20-2012, Shkresë e MPJ për konsullin a-h në Shkodër Kral, datë 8 prill 1916.

⁴⁴ *AQSH*, F. 235, D. 11, fl. 1, Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Financave, drejtuar Zyrës së Financave Krugë, Shkodër, 1 gusht 1916.

⁴⁵ *HHSStA*, PA, A, në *AIH*, Vj. 27-1-163, Shkresë e MPJ drejtuar kontit von Storck në Baden, Vjenë, 9 gusht 1916.

absolut të shërbimit të administratës në Shqipëri”. Zhvillimi i sistemit tatimor, kishte rëndësi mjaft të madhe për zhvillimin e ardhshëm të vendit pasi ai ishte parakusht “për ekzistencën e një Shqipërie autonome të mëvonëshme...”⁴⁶. Ky model tatimor u dëshmoi drejtuesve të elitës politike shqiptare se menaxhimi i duhur i burimeve financiare kishte rëndësi vendimtare për qëndrueshmërinë e shtetit kombëtar. Mbledhja e rregullt dhe në mënyrë të ndershme e taksave, ishte burim kryesor financiar dhe mjeti më i rëndësishëm që ndikonte në rimëkëmbjen dhe stabilizimin e jetës kombëtare të shtetit.

Nacionalistët shqiptarë u përpoqën të shfrytëzonin çdo rrethanë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës kombëtare. Me pëlqimin e Komandës së Lartë Ushtarake në Shkodër u formua “Komsia Letrare”⁴⁷. Ajo drejtohej nga intelektualë të shquar shqiptarë dhe pati si objektiva kryesore, zgjidhjen e çështjes së drejtshkrimit të gjuhës zyrtare shqipe, hedhjen e themeleve të një gjuhe të përbashkët letrare⁴⁸, krijimin e fjalëve të reja që i mungonin gjuhës shqipe si dhe nxitjen e botimit dhe korrektimit të librave e teksteve shkollore në gjuhën shqipe. “Komsia Letrare” dha një kontribut të rëndësishëm për unifikimin e dy dialekteve të gjuhës shqipe si për zhvillimin e gjuhës së përbashkët letrare shqipe. Gjuha e përbashkët e njësuar, përbënte faktorin kryesor që ndikonte drejtpërdrejt në forcimin e idesë kombëtare dhe ngjizjen e çdo kombi. Ajo vlente më tepër tek shqiptarët, pasi ideologjia e tyre kombëtare mbështetej tërësisht në gjuhën shqipe.

Në vitin shkollor 1916-1917 në territorin e Shqipërisë të okupuar nga forcat austro-hungareze u hapën 24 shkolla. Shumica e tyre ishin shkolla të ngritura kryesisht në fshatra⁴⁹. Gjatë kësaj periudhe u shpall në parim, detyrimi i përgjithshëm shkollor për djemtë nga mosha 7 deri në 14 vjeç. Vetëm gjatë vitit 1917, në territorin e Shqipërisë funksionuan gjithsej 224 shkolla fillore⁵⁰, shifër që tregon rëndësinë që i kushtoi nacionalizmi

⁴⁶ *Po aty*, Vj. 27-5-552, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 30 shtator 1917.

⁴⁷ Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë – Pejë: “Dukagjini”, 1997, f. 285.

⁴⁸ Karl Gurakuqi, “Jeta dhe veprat e Fishtës”, *Shkëndija*, Tiranë, 1941, f. 15.

⁴⁹ *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-1-109, Raport i konsullit të Përgjithshëm Kral, drejtuar kontit Czernin, Shkodër, 17 qershor 1917.

⁵⁰ *Po aty*, Vj. 27-1-108, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral për arsimin e Shqipërisë në prill 1917, Shkodër, 17 qershor 1917; Kuntim: “Detyra e të ndjekunit të shkollës”, Drejtorija e Arsimit të Shkodrës, Nr. 713/I”, *Posta e Shqypniës*, Shkodër,

shqiptar zhvillimit të shkollës shqipe. Me qëllim që shqiptarët të përfitonin sa më shumë dhe më shpejt nga kultura perëndimore, rreth 84 të rinj dhe të reja shqiptare u dërguan për të studiuar në degë të ndryshme civile në universitetet austro-hungareze. Gjithashtu, 25 të rinj të tjerë shqiptarë u dërguan për të studiuar në institucionet e edukimit ushtarak në Vjenë dhe në Budapest⁵¹.

Arritje tjetër kombëtare në fushën e arsimit, ishte ngritja e mjaft shkollave fillore në territoret e banuara nga shqiptarë në Mal të Zi dhe në Kosovë⁵², të cilëve më parë nuk u lejohej mësimi në gjuhën shqipe. Këto shkolla funksionuan nga viti 1916 deri në vitin 1918, kur Kosova u pushtua përsëri nga trupat serbe⁵³. Në të gjitha shkollat ku kishte shqiptarë, mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe “duke realizuar plotësisht shqiptarizimin e të gjithë arsimit të vendit”. Përhapja e shkollave shqipe në këto vise ishte faktor që ndikonte në unifikimin kulturor dhe “rrezimin e kufijve politikë” të vendosur në Londër. Gjatë këtyre viteve për shkollat shqiptare u hartuan dhe u zbatuan plane dhe programe mësimore, të mbështetura në modelin austriak, të cilat patën rrezatim edhe në periudhën e mëvonshme. Ministria e Punëve të Jashtme mori përsipër botimin e një numri tekstesh shkollorë mbështetur në dialektin e Elbasanit sipas rregullores së hartuar nga “Komsia Letrare”. Ato shërbyen si modele pozitive, të cilave u janë referuar arsimtarët dhe metodistët shqiptarë. Drejtuesit e arsimit ndërtuan një sistem burokratik raportimi nga qendra në bazë dhe anasjelltas, i cili koordinonte saktësisht veprimtarinë mësimore, pagesat financiare të mësuesve edhe në fshatrat më të largët të Shqipërisë⁵⁴. Gjatë kësaj kohe, arsimtarët dhe nacionalistët

nr. 78, 14 shtator 1918, f. 4; “Lajme vendit. Kshilli shkolluer i Shkoders”, *Posta e Shqypënie*, Shkodër, nr. 33, 31 mars 1917, f. 3-4.

⁵¹ “Lajme vendit. Zansa shqyptarë n’Monarkië”, *Posta e Shqypnie*, Shkodër, nr. 87, 6 tetor 1917, f. 3; “Djelmt shqyptarë n’Kadetenxhule”, *Posta e Shqypnie*, Shkodër, nr. 79, 5 shtator 1917, f. 3.

⁵² *HHStA, PA, A, në AIH*, Vj. 26-14-1465, Telegram shifër i përfaqësuesit a-h në Cetinë drejtuar MPJ, Cetinë, 30 shtator 1916; *Po aty*, Vj. 26-20-2076, Protokoll i mbajtur më 2/II/1917 në pallatin qeveritar dhoma nr. 474 në Cetinë, Mali i Zi; *Po aty*, Vj. 26-17-1798, Shkresë sekrete nr. 25/P e ministrit a-h Szecheny, drejtuar baronit Burian, Beograd, 7 tetor 1916.

⁵³ Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (1918-1924)*, Prishtinë: 1997, f. 16.

⁵⁴ *AQSH*, F. 271, D. 9, fl. 48, Shkresë e Pleqësisë së katundit Muriqan drejtuar drejtorit të krahinës Dumre, 17 mars 1917.

shqiptarë punuan që “të ngjallnin shpirtin e Skandërbegut nder zemra t’gjith Shqyphtarvet”, si simbol i bashkimit kombëtar për shqiptarët⁵⁵.

Ndryshe nga mënyra se si kishin vepruar forcat bullgare ndaj shqiptarëve në zonën që mbahej e pushtuar prej ushtrisë së tyre, autoritetet ushtarake austro-hungareze synuan të bënin për vete shqiptarët në viset etnike të mbetura në Mal të Zi dhe Serbi. Shqiptarët fituan disa të drejta kombëtare, të cilat kishin vlerë të madhe⁵⁶. Në viset shqiptare të aneksuara më parë nga Serbia dhe Mali i Zi, u vendos që mbiemrat e familjeve shqiptare, të cilave u ishte vënë prapashtesa “viç” me qëllim sllavizimi, të ndryshoheshin duke i kthyer në formën e mëparshme. Megjithatë, qeveria austro-hungareze nuk lejoi që të drejtat kombëtare të shqiptarëve të tejkalonin objektivat e politikës së tyre⁵⁷.

Gjatë harkut të shkurtër kohor të dy viteve, elita politike shqiptare e kuptoi qartë se “çdo qeveri, e cila dëshironte të ruante stabilitetin brenda vendit dhe të fitonte besimin e popullsisë, apo së paku të shumicës së saj në Shqipëri, duhej të ishte e paanshme, e singertë, e drejtë dhe t’i trajtonte të gjithë palët në mënyrë të barabartë”⁵⁸. Për forcimin e identitetit kombëtar të shumicës së shqiptarëve, konsulli Kral parashtrroi kërkesën që në krye të viseve shqiptare të emërohej një kryemyfti vendas duke marrë miratimin edhe nga Sheh-ul Islami në Stamboll⁵⁹. Kjo kërkesë u hodh poshtë nga qeveria austro-hungareze. Pas datës 18 maj 1918, të gjitha proceset gjyqësore të Sheriatit në Shqipëri filluan të kryheshin në gjuhën shqipe⁶⁰. Për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile dhe tregtare u parashikua që në qytetet më të mëdha të ngriheshin gjykata

⁵⁵ Gj. Fishta, “Mas 450 vjetsh”, *Posta e Shqypënie*, Shkodër, nr. 12, 17 janar 1917, f. 1.

⁵⁶ Limon Rushiti, *Rrethanat shoqëroro-politike në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë: 1986, f. 192.

⁵⁷ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 27-4-467*, Relacion i Feldmareshall-leitnant Veber, drejtues i Guvernës së Përgjithshme të Ushtrisë austro-hungareze në Mal të Zi, drejtuar Kryekomandës së ushtrisë, Cetinë, 15 korrik 1917; *Po aty, Vj. 27-3-344*, Telegram nr. 76 i ministrit të Punëve të Jashtme Czernin, drejtuar konsullit të Përgjithshëm Kral, Vjenë, 23 nëntor 1917.

⁵⁸ *Po aty, Vj. 27-9-925*, Raport tepër rezemat i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar kontit Otokar Czernin, Shkodër, 14 tetor 1917.

⁵⁹ *Po aty, Vj. 26-1-173*, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar ministrit të Jashtëm Burian, Shkodër, 11 gusht 1916.

⁶⁰ *Po aty, Vj. 28-68*, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h në Shkodër Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 14 qershor 1918; “Gjuha shqype gjuhë zyrjet në gjyqje të Sheriatit”, nga Korpskomanda p. e mb. XIX. E. V. nr. 3962/III”, *Posta e Shqypniës*, Shkodër, nr. 56, 29 qershor 1918, f. 4.

me një gjykatës me emërtimin “Gjykata Paqtimi”. Në Shkodër, e cila ishte kryeqendra administrative e territorit nën administrimin austro-hungarez, u ngrit një gjykatë kolegjiale e instancës së dytë me emërtimin “Gjykata e Apelimit”⁶¹.

Arritje tjetër e rëndësishme gjatë Luftës së Parë Botërore, në drejtim të përhapjes së ideve kombëtare dhe rritjes së intensitetit të komunikimit ndërmjet shqiptarëve, ishte ndërtimi i rrugëve të transportit që lidhnin viset shqiptare. Gjatë kësaj kohe u ndërtuan dhe u përmirësuan afro 739 km rrugë automobilistike, u ndërtuan disa ura të rëndësishme, u ngrit një rrjet dekovilësh (hekurudha të ngushta mbi të cilat lëviznin mjete transporti të tërhequra nga kuaj) me një gjatësi prej 196.2 km. Gjatësia e rrjetit të teleferikëve të ndërtuar në tokat e banuara nga shqiptarë ishte 59 km. Krahas ndërtimit e përmirësimit të rrugëve të komunikimit, u punua edhe për përmirësimin dhe riparimin e skelave detare dhe liqenore⁶². Komunikimi ndërmjet krahinave shqiptare u përmirësua falë ngritjes edhe të zyrave postare austro-hungareze në Shkodër, Durrës, Lezhë, Tiranë, Elbasan dhe në Zhur⁶³.

Një projekt tjetër i rëndësishëm ishte fushata për regjistrimin e popullsisë shqiptare në viset e kontrolluara prej forcave austro-hungareze. Për nacionalizmin shqiptar, njësoj si për nacionalizmat e tjerë mbeti shqetësim i përhershëm, njohja e zhvillimeve demografike brenda tij për të hartuar më mirë synimet dhe objektivat e veta. Procesi i regjistrimit të popullsisë nisi më 1 mars 1918. Regjistrimi i popullsisë pati rëndësi pasi kryhej për herë të parë që nga periudha osmane. Ai u realizua duke evidentuar në mënyrë të paanshme përkatësitë fetare, krahinore apo etnike të individëve. Administrata austro-hungareze vendosi që identiteti

⁶¹ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-16-1660, Shkresë nr. 1016/ 2 rez. Organizimi provizor i gjyqeve civile në Shqipëri, Shkodër, 8 tetor 1916.*

⁶² *Po aty, Vj. 27-7-772, Raporti i konsullit të Përgjithshëm Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 7 janar 1917; Koço Miho, Shqipëria – Vështrim urbanistik (1912-1944), Tiranë: Extra, 2003, f. 22. [K. Miho shkruan se gjatësia e rrugëve të ndërtuara dhe të përmirësuara nga ushtritë austro-hungareze në automobilistike, teleferikut dhe dekovilit shkon në 650 km.]*

⁶³ *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-20-2016, Shkresë e Visner, përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme pranë Komandës supreme të Ushtrisë, drejtuar Kral, konsullit të Përgjithshëm a-h në Shkodër, Teshen, 14 qershor 1916.*

kombëtar i çdo banori të regjistruar, të mbështetej në deklarin personal të secilit person të pyetur⁶⁴.

Autoritetet austro-hungareze vendosën kontrollin për lëvizjet e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Pa u pajisur me një dokument identifikimi, shqiptarët nuk mund të lëviznin jo vetëm jashtë vendit, por edhe nga njëri qark administrativ në tjetrin. Më parë, kjo masë është parë vetëm në këndvështrimin negativ për interesat e vendit⁶⁵. Duhet pranuar, se pozitiv pasi ndikoi në forcimin e identitetit kombëtar të tyre, sepse në të gjitha dokumentet e lëshuara nga autoritetet ushtarake bëhej shënimi i kombësisë shqiptare duke braktisur identitetin e mbështetur në besimin e tyre fetar. Njëkohësisht, kjo masë ndikoi tek shqiptarët në forcimin e idesë se shteti kishte të drejtën dhe detyrën të ishte i informuar për lëvizjet e shtetasve të tij e të huaj si dhe të kontrollonte kufijtë e shtetit dhe territorin e tij⁶⁶.

Në pranverë të vitit 1916, në vend u krijua një forcë “vullnetare” e xhandarmërisë shqiptare⁶⁷. Komanda ushtarake austro-hungareze nuk pati sukses në shtimin e radhëve me vullnetarë shqiptarë. Thelbi i kundërshtimit të shqiptarëve për të marrë pjesë në formacionet ushtarake austro-hungareze lidhej me faktin se ata përdorshin si “mish për top”. Oficerët austro-hungarezë në Shqipëri nuk kishin besim tek shqiptarët, pasi ata fyenin hapur nivelin kulturor dhe kombësinë e tyre⁶⁸. Gjithashtu, formacionet me ushtarë shqiptarë nuk u lejuan të përdornin flamujt shqiptarë si dhe shqipen si gjuhë komandimi. Pavarësisht synimit të autoriteteve ushtarake austro-hungareze për t’i përdorur shqiptarët për interesa të tyre, një pjesë e oficerëve shqiptarë të shkolluar e të trajnuar

⁶⁴ *Po aty*, Vj. 28-6-690, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 27 maj 1917; *Po aty*, Vj. 28-8-826, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral drejtuar MPJ, Shkodër, 27 maj 1917; *Po aty*, Vj. 26-16-1601, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar ministrit të Jashtëm baronit Burian, Shkodër, 16 nëntor 1916; F. Seiner, *Numrim i parë...*, f. 9.

⁶⁵ M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet...*, f. 264.

⁶⁶ *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-8-830, Rregullore nr. K 258/ 1916 e udhëtimeve dhe e policisë për të huaj, shpallur nga Komanda supreme Perandorake dhe Mbretërore në Shqipëri, Shkodër, qershor 1916.

⁶⁷ “Lajme vendit. Vullnetarët e Shqypniës”, *Posta e Shqypnies*, Shkodër, nr. 54, 13 qershor 1917, f. 3.

⁶⁸ *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-4-439, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar Alfred von Rappaport, Shkodër, 7 gusht 1916.

prej tyre rezultuan më pas një burim me vlerë për ngritjen e strukturave drejtuese të ushtrisë së shtetit shqiptar.

Aspekt i rëndësishëm i përpjekjeve të forcave nacionaliste shqiptare ishte synimi për bashkimin e tokave etnike shqiptare. Nën ndikimin e elitës kombëtare shqiptare, në fillim të muajit shkurt 1916, konsulli i Përgjithshëm Kral, i propozoi ministrit të Jashtëm Burian, që Shqipëria në pjesën veriore, “të zgjanohej me toka thjesht shqiptare që deri tani kanë qenë të Malit të Zi dhe të Serbisë” dhe vënien e tyre nën administrimin e Komandës së Korparmatës XIX⁶⁹. Duke besuar se austro-hungarezët, dhe veçanërisht konsulli Kral, ushqenin një simpati për shqiptarët, nacionalistët irredentistë shqiptarë me në krye Hasan Prishtinën, qysh në nëntor të vitit 1916, i dorëzuan konsullit Kral një memorandum, i cili kërkonte zgjerimin e kufijve të territorit të okupuar nga forcat austro-hungareze. Nacionalistët shqiptarë kërkonin bashkimin me Shqipërinë e pushtuar nga trupat austro-hungareze të krahinave të Pejës, Gjakovës, Gucisë, Mitrovicës dhe Vuçiternit, me qëllim që të krijohej një njësi e vetme e shtetit shqiptar. Hasan Prishtina argumentonte se bashkimi i territoreve të mësipërme do të ushtronte një ndikim të madh në përpjekjet për bashkimin e kombit shqiptar si dhe do të ushtronte njëfarë presioni edhe mbi Bullgarinë për lëshimin e territoreve shqiptare të pushtuara prej saj që banoheshin nga populli thjesht shqiptarë, të cilat me të drejtë duhej t’i përkisnin Shqipërisë⁷⁰.

Drejtuesit e nacionalizmit shqiptar nga viset e Kosovës i kërkuan përfaqësuesve të qeverisë austro-hungareze mbështetje për çlirimin e Kosovës e viseve të tjera shqiptare nga sundimi serb. Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë austro-hungareze, njësoj si në takimin që mbajti në Kastelnuovo në mesin e korrikut 1914 me Hasan Prishtinën e Isa Boletinin nuk u dha atyre asnjë premtim⁷¹. Drejtuesit austro-hungarezë ishin të mendimit se bashkimi i këtyre viseve me territorin shtetëror shqiptar do të merrej si model nga shqiptarët e Malit të Zi për të shfaqur

⁶⁹ *Po aty*, Vj. 26-7-736, Telegram shifër e MPJ austro-hungareze, drejtuar Princit Hohenlohe në Berlin, Vjenë, 2 shkurt 1916; *Po aty*, Vj. 26-3-368, Letër konfidenciale e ministrit të Jashtëm Burian drejtuar konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, Shkodër, 13 qershor 1916.

⁷⁰ *Po aty*, Vj. 26-7-747, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar ministrit të Jashtëm baronit Burian, Shkodër, 30 nëntor 1916.

⁷¹ Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864-1916)*, Tiranë: Shkenca, 2004, f. 194.

aspirata të njëjta⁷². Kryekomanda e ushtrisë austro-hungareze doli me qëndrimin se krijimi i “unitetit të Shqipërisë” nëpërmjet vendosjes së patronazhit austriak në këtë periudhë nuk paraqiste rëndësi politike⁷³. Kundër bashkimit të viseve shqiptare doli sidomos guvernatori i përgjithshëm ushtarak i Malit të Zi, konti Heinrich Karl Klam-Martiniç. Kundërshtimi i tij mbështetej në këto argumente: së pari, sllavët e jugut ishin më të rëndësishëm për Monarkinë se shqiptarët; së dyti, Austro-Hungaria duhej t’i druhej më tepër irredentizmit jugosllav sesa irredentizmit shqiptar pasi ky i fundit nuk ekzistonte⁷⁴.

Gjatë viteve 1916-1918, pavarësisht përpjekjeve të elitës kombëtare, në mesin e shqiptarëve nuk u vërejt një organizim dhe veprim i njëjtë politik. Lidhjet e nacionalistëve ishin të shkëputura, në disa raste të vështira, duke nxjerrë në pah dobësinë e nacionalizmit shqiptar në drejtim të organizimit dhe shfrytëzimit më të mirë të hapësirave të krijuara nga prania e disa ushtrive të huaja. Vendi mbeti i përçarë dhe i organizuar në mënyra dhe sisteme të ndryshme qeverisjeje⁷⁵.

S u m m a r y

ASPECTS OF THE ALBANIAN NATIONALISM DURING 1916-1918 IN THE ALBANIAN TERRITORY UNDER THE AUSTRO-HUNGARIAN OCCUPATION

The First World War gave a heavy blow to the state and Albanian nationalism. In the spring of 1915, in Shkodra was formed the nationalist organization “Secret Committee”, which aimed the liberation of Kosovo and its unification with the Albanian state. During the war, the Pan Albanian Federation “Hearth” in USA became the most powerful Albanian national

⁷² *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-3-1216, Kopje e urdhërit nr. 150 të Kryekomandës së ushtrisë Perandorake dhe Mbretërore, drejtuar komandës së Korparmatës XIX në Shkodër, 10 dhjetor 1916.*

⁷³ *Po aty, Vj. 26-4- 437, Raport i D. Turn, drejtuar ministrit të Jashtëm a-h, baronit von Burian, Teshen, 7 gusht 1916.*

⁷⁴ *Po aty, Vj. 27-2-255, Raport i konsullit të Përgjithshëm a-h Kral, drejtuar MPJ, Shkodër, 20 dhjetor 1917.*

⁷⁵ T. Selenica, *Shqipëria më 1937...*, f. 101.

organization. Its leaders drafted a national program, which envisaged maintaining the neutrality of Albanians during the war. Albanian nationalists raised two main political objectives: forming of the Albanian government and calling of a national congress to determine the future of the Albanian issue.

Albanian nationalists were disappointed especially by the Austro-Hungarian concept of the political “immaturity” of Albanians and denial of their national feelings. However, they tried to benefit from the concessions of the Austro-Hungarian authorities in favor of national issues. The administration’s model applied by the Austro-Hungarians in Albania stimulated the social mobilization and overturned the cultural boundaries among Albanians. This model was used by Albanian political leaders during the post war period. The irredentist Albanian nationalists’ leaders demand for the unification of Kosovo and other Albanian territories to the state trunk was not supported by the Austro-Hungarian government. During 1916-1918, despite the efforts of the national elite, it was not achieved a common organization and a coherent political action among Albanians. Lack of unity revealed again the weakness of Albanian nationalism.